



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA JURIDIKE DHE PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARDEVE  
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_. 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT  
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

**19.06.2024**

Drejtuar:

**Operatorit Ekonomik  
“ALB - STAR”**

**Tirane Tirane TIRANE Sheshi Italia, Arena Center, Seksioni D, Kati 5**

Procedura e prokurimit/lotit: **“E Hapur - punë publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-99897-04-02-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Zgjerimi i rrugës Elbasan- Qafë- Thanë (Faza VI)”**

**Fondi limit: 2,488,938,322.84** (dy miliard e katërqind e tetëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e njëzet e dy presje tetëdhjetë e katër) **Lekë, pa TVSH.**

Në Euro: **24,244,480.05** (njëzet e katër milion e dyqind e dyzet e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë presje zero pesë) **Euro pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **24 muaj**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto **X**

Sipas rëndësisë:

Çmimi <input type="checkbox"/>	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe metodologjia <input type="checkbox"/>	pikët 15
Stafi / Organizimi i Kompanisë <input type="checkbox"/>	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social <input type="checkbox"/>	pikët 10
Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit <input type="checkbox"/>	pikët 10

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. “A. N. K.”**

**J92408001N**

Vlera: **2,338,551,487.42** (dy miliard treqind e tridhjetë e tetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë presje dyzet e dy) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

**2. “ALB - STAR”**

**J62903512W**

Vlera: **2,347,709,428.93** (dy miliard e treqind e dyzet e shtatë milion e shtatëqind e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tetë presje nëntëdhjetë e tre) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **279.30**

**3. “GJOKA KONSTRUKSION”**

**J91815014U**

Vlera: **2,490,024,774.85** (dy miliard e katërqind e nëntëdhjetë milion e njëzet e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër presje tetëdhjetë e pesë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

#### 4. “ALB-BUILDING”

**J69102508C**

Vlera: **2,388,830,751.30** (dy miliard e treqind e tetëdhjetë e tetë milion e tetëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë presje tridhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **272.40**

#### 5. BOE “BAMI HOLDING” SHPK & “CURRI” SHPK & “BE - IS SH.P.K”

**J94416206R / J67902718S / K71412003A**

Vlera: **2,400,595,713.73** (dy miliard e katërqind milion e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e trembëdhjetë presje shtatëdhjetë e tre) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

#### 6. BOE “RSM Company” SHPK & “AURORA KONSTRUKSION” SHPK & “DESARET COMPANY” SHPK

**810802422 / K02017003I / K01816001J**

Vlera: **2,097,776,556** (dy miliard e nëntëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

***1. Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “RSM Company” SHPK & “AURORA KONSTRUKSION” SHPK & “DESARET COMPANY” SHPK, me Numër NIPTI 810802422 / K02017003I / K01816001J, pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST, konkretisht:***

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1

*“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme*

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllëgaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet”.*

Operatorët ekonomikë janë mbështetur për punën e ngjashme në operatorë të tjerë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë të gjithë elementet e përcaktuar në **nenin 90 “Mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera”** të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, pikërisht në pikën 2 të këtij neni “Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
- .....
- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

**Gjithashtu në pikën 5 të nenit 90 citohet:** “Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkojnë këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm”.

-Stafi i paraqitur nga bashkimi i operatorëve nuk është në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit, kjo, në kundërshtim me **nenin 88 “Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë”**, VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, pika 3 “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.**

-OE “RSM COMPANY” nuk përmbush kriterin 2.3.4 stafin mbështetës, pasi stafi i deklaruar në shtojcën 8 është i angazhuar, kjo, në kundërshtim me pikën 2.3.4 ku thuhet: “Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura të shpallura fituese”

-OE “RSM COMPANY” nuk përmbush kriterin 2.3.7 “Mjetet dhe pajisjet e kerkuara”, pasi mjetet e vetëdeklaruara në shtojcën 8 janë të angazhuara, kjo, në kundërshtim me pikën 2.3.7 ku thuhet: “Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura te shpallura fituese”.

**2. Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “BAMI HOLDING” SHPK & “CURRI” SHPK & “BE - IS SH.P.K”, me Numër Nipti J94416206R / J67902718S / K71412003A, pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST, konkretisht:**

BOE, nuk permbush piken 2.3.4 “Stafi mbeshtetes”, pasi stafi i vetdeklaruar ne shtojcen 8 , eshte i angazhuar, kjo ne kundershkrim me kriteret e kualifikimit. **Stafi i kerkuar ne pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

BOE nuk permbush kriterin 2.3.7 “ Mjetet dhe pajisjet e kerkuara” pasi, mjetet e vetdeklaruar ne shtojcen 8, jane te angazhuara, kjo ne kundershkrim me piken 2.3.7 ku thuhet; “*Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar ne procedura te shpallura fitues*”.

***3.Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “GJOKA KONSTRUKSION” SHPK, me Numër NIPTI J91815014U, pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kerkuara në DST, konkretisht:***

Operatori ekonomik GJOKA KONSTRUKSION ka paraqitur ofertën ekonomike mbi fondin limit.

***4.Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “A. N. K.”, me Numër NIPTI J92408001N, pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kerkuara në DST, konkretisht:***

OE nuk permbush piken 2.3.4 “Stafi mbeshtetes”, pasi stafi i vetdeklaruar ne shtojcen 8 , eshte i angazhuar, kjo ne kundershkrim me kriteret e kualifikimit. **Stafi i kerkuar ne pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Gjithashtu “OE” nuk permbush kriterin 2.3.7 “ Mjetet dhe pajisjet e kerkuara” pasi, mjetet e vetdeklaruar ne shtojcen 8, jane te angazhuara, kjo ne kundershkrim me piken 2.3.7 ku thuhet; “*Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar ne procedura te shpallura fitues*”.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “ALB - STAR”**, me adresë: **Tirane Tirane TIRANE Sheshi Italia, Arena Center, Seksioni D, Kati 5**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **2,347,709,428.93** (dy miliard e treqind e dyzet e shtatë milion e shtatëqind e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tetë presje nëntëdhjetë e tre) **Lekë pa TVSH** / totali i pikëve të marra sipas sistemit **[279.30]**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [**Autoritetit Rrugor Shqiptar, adresa: rruga “Sami Frashëri” Nr.33, Tiranë. E-mail:info@arrsh.gov.al. Tel: 042234487**] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj), siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anulimit të Procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Gentian Gjyli**